



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 33 prot.

Kamëz, më 21 .03. 2024

V E N D I M

Nr 33 Datë 21/03 / 2024

PËR

“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT TË BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.03.2024, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.29 Datë 18.03.2024 në mbështetje të nenit 8, neni 9/1 pika 1/a dhe b, nenin 54 pika a, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Këshilli Bashkiak Kamëz;

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz
2. Rregullorja e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në Aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Vendimi Nr.25, datë 13.02.2020, “Për Miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Kamëz”, shfuqizohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

RREGULLORE
PËR

“ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT
BASHKIAK KAMËZ”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

PËRMBAJTJA:

KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i Rregullores
2. Përkufizime
3. Bashkia Kamëz
4. Stema dhe vula e Këshillit Bashkiak Kamëz
5. Selia dhe vula e Këshillit Bashkiak
6. Organet e qeverisjes të Bashkisë Kamëz
7. Këshilli Bashkiak
8. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi

KREU II: KONSTITUIMI I KËSHILLIT BASHKIAK

9. Numri dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Bashkia
10. Thirrja e mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak
11. Mbledhja e parë e Këshillit Bashkiak
12. Komisioni i verifikimit të mandateve
13. Papajtueshmëria me funksionin e këshilltarit
14. Betimi i këshilltarëve
15. Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak
16. Sekretari i këshillit
17. Mandati i Kryetarit të Bashkisë
18. Zgjedhja e përfaqësuesve të Këshillit të Qarkut
19. Mbarimi i mandatit të këshilltarit
20. Të drejtat e këshilltarit
21. Konflikt interesi
22. Mandati dhe mbledhjet e Këshillit Bashkiak Kamëz
23. Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak Kamëz

KREU III: KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK KAMËZ

24. Kryesia e Këshillit Bashkiak Kamëz
25. Kryetari i Këshillit Bashkiak Kamëz
26. Sekretari i Këshilli Bashkiak Kamëz
27. Sekretaria e Këshillit Bashkiak

KREU IV: GRUPIMET E KËSHILLTARËVE

28. Grupet e këshilltarëve
29. Kushtet për anëtarësimin në grup



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

30. Mbledhjet e grupeve të këshilltarëve

KREU V: KOMISIONET E KËSHILLIT

31. Komisionet e përhershme
32. Drejtuesit e komisioneve të përhershme
33. Veprimtaria e komisioneve të përhershme
34. Mbledhjet e komisioneve të përhershme
35. Komisionet e përkohshme
36. Kontrolli i brendshëm financiar

KREU VI: FINANCIMI I AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT

37. Buxheti vjetor i shpenzimeve të Këshillit Bashkiak Kamëz
38. Miratimi i projektbuxhtit vjetor të Këshillit Bashkiak
39. Shpërblymimi dhe rimbursimi i këshilltarëve
40. Raporti i shpenzimeve vjetore të Këshillit Bashkiak Kamëz
41. Seancat e këshillimeve me bashkësinë
42. E drejta e publikut për t'u informuar
43. Përgatitja dhe propozimi i projektakteve në Këshillin Bashkiak
44. Organizimi i shqyrtimit të projektaktit
45. Procedura e zhvillimit të mbledhjeve
46. Radha e diskutimeve
47. Çështjet procedurale
48. Kohëzgjatja e diskutimeve
49. Replika gjatë diskutimeve
50. Ndërprerja apo mbledhja e diskutimeve
51. Sjellja e këshilltarëve gjatë mbledhjes së këshillit dhe komisioneve
52. Rregulli në mbledhjet e këshillit/komisioneve
53. Masat disiplinore
54. Dhënia e masave disiplinore
55. Votimi në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Kamëz
56. Raportet e kryetarit të bashkisë me Këshillin
57. Procesverbali i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Kamëz
58. Hyrja, vendosja e këshilltarëve e të ftuarëve dhe siguria në sallën e mbledhjeve/komisioneve
59. Dispozita të fundit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përmban rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Kamëz, procedurën e paraqitjes, shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve, sjelljen e këshilltarëve dhe marrjen e masave disiplinore ndaj tyre, si dhe marrëdhëniet e këshillit me kryetarin dhe administratën e Bashkisë.

Neni 2
Përkufizime

1. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm, kanë këto kuptime:
 - a. “Ligji nr. 139/2015”, nënkupton ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, tëndryshuar”.
 - b. “Këshilli”, është Këshilli Bashkiak Kamëz;
 - c. “Këshilltar”, është anëtari i Këshillit Bashkiak Kamëz, i zgjedhur sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor dhe i është vërtetuar mandati nga këshilli bashkiak.
 - d. “Kryetar”, është Kryetari i Këshillit Bashkiak Kamëz.
 - e. “Sekretar”, Sekretari i Këshillit Bashkiak Kamëz.
 - f. “Bashkia”, është Bashkia Kamëz;
2. Kryetari i Bashkisë”, nënkupton Kryetarin e Bashkisë Kamëz.

Neni 3
Bashkia Kamëz

Bashkia Kamëz, përfaqëson një unitet administrativo territorial, një bashkësi banorësh e organizuar në 1 (një) njësi administrative dhe 3 (tre) lagje të qeverisjes vendore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 139/2015 dhe legjislacionit për ndarjen territoriale në Republikë Shqipërisë.

Neni 4
Stema dhe vula e Këshillit Bashkiak

1. Këshilli përdor stemën e Republikës së Shqipërisë dhe vulën zyrtare të bashkisë, sipas legjislacionit në fuqi. Këshilli Bashkiak, bazuar në traditën dhe historinë e qytetit, miraton me vendim Stemën e Bashkisë.
2. Stema e Bashkisë përdoret në mjediset e Bashkisë dhe në mjediset e punës së Këshillit, në mjediset publike, në dokumente e akte të brendshme të Këshillit, në korrespondencën e Këshillit me të tretë, në botime e publikime të Këshillit, ose në veprimtaritë që organizohen nga Këshilli.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

**Neni 5
Selia e Këshillit Bashkiak**

Selia e Këshillit Bashkiak ndodhet në godinën qendrore të Bashkisë Kamëz në Bulevardin “Nënë Tereza”.

**Neni 6
Organet e qeverisjes të Bashkisë Kamëz**

Organi përfaqësues i Bashkisë Kamëz është Këshilli Bashkiak. Organi ekzekutiv është Kryetar i Bashkisë. Në përputhje me parashikimet ligjore dhe për interesin publik, organet e Bashkisë Kamëz ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhërësave dhe urdhrave.

**Neni 7
Këshilli Bashkiak**

1. Këshilli Bashkiak gëzon të drejtat, kryen funksionet dhe ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë, ligjin nr. 139/2015, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Këshilli Bashkiak ndërmerr nisma në interes publik vendor të Bashkisë Kamëz për çdo çështje që nuk ndalohet me ligj, ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj.
3. Këshilli Bashkiak, bashkëpunon me organet e tjera të qeverisjes vendore dhe të qeverisjes qendrore, për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta në dobi të komunitetit.

**Neni 8
Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi**

1. Këshilli në ushtrimin e veprimtarisë së tij, zbaton kërkesat e ligjit nr. 139/2015 dhe ligjit nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
2. Këshilli në vendimmarrje e tij për ofrimin e shërbimeve publike, mundëson hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish të performancës së ofrimit të shërbimeve, përfshirë edhe treguesit gjinor.
3. Këshilli në ushtrimin e veprimtarisë së tij, zbaton kërkesat e nenit 15/1/a të ligjit nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i cili parashikon përfaqësimin e barabartë gjinor duke siguruar sëpaku përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, në organet e tij kryesuese dhe në komisionet, komitetet ose bordete e ngritura nga këshilli, si dhe respektimin në mënyrë të njëjtë, për secilën gjini, të procedurave dhe kritereve të konkurimit, gjatë emërimit në organet kryesuese, duke e konsideruar barazinë gjinore si një tregues të qeverisjes së mirë.
4. Këshilli zbaton kërkesat ligjore për barazinë gjinore si në rastin e zgjedhjes së kryetarit ashtu dhe zëvendëskryetarëve të këshillit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

5. Në rastin e krijimit të vendit bosh, që lidhet me humbjen e mandatit të anëtarit të këshillit të qarkut nga një anëtar i Këshillit Bashkiak, ai zëvendësohet nga këshilli, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.
6. Këshilli, në procesin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm, mundëson që të paktën një nga objektivat e politikave të programeve të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore.
7. Këshilli, në përgjegjësinë e tij për miratimin e mënyrës dhe rregullave të votimit për përbërjen e kryesisë së fshatit, si dhe në përcaktimin e rregullave të përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve, mundëson respektimin e ligjit për barazinë gjinore.
8. Këshilli, nëpërmjet sekretariatit të tij, harton dhe përditëson evidencën me të dhëna mbi përfaqësimin gjinor në Këshill dhe në strukturat e ngritura nga Këshilli dhe e raporton atë në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë, si dhe grumbullon, mirëmban dhe publikon të dhëna gjinore për pjesëmarrjen e publikut në aktivitetet e organizuara nga këshilli, si në rastin e dëgjësive dhe takimeve të tjera me publikun.
9. Këshilli, në veprimtarinë e tij, duhet të respektojë kërkesat e ligjit nr. 10221 datë 4.2.2010 "Përmbrojtjen nga diskriminimi", sipas së cilit askush nuk mund të diskriminohet në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e veçantë, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

KREU II
KONSTITUIMI I KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 9

Numri dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit

Këshilli përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Numri i këshilltarëve përcaktohet sipas parashikimeve të këtij kodi dhe ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Neni 10

Thirrja e mbledhjes së parë të këshillit

1. Këshilli Bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjes nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
2. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i tij. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr Prefekti.
3. Data për mbajtjen e mbledhjes së parë të këshillit përcaktohet nga sekretari në konsultim me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- kryetarin në detyrë dhe Kryetarin e sapo zgjedhur të Bashkisë dhe i njoftohet Prefektit. Në mungesëtë sekretarit, Prefekti konsultohet me Kryetarin në detyrë dhe Kryetarin e Bashkisë të sapo zgjedhur, përpara se të caktojë datën e thirrjes së mbledhjes së parë të këshillit.
4. Sekretari, në mungesë apo pamundësi të Prefektit, thirrjen e mbledhjes së parë të këshillit e njofton në këndin e njoftimeve për publikun të Bashkisë Kamëz, në median vendore dhe në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.
 5. Sekretari dhe/ose Prefekti merr informacionin zyrtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, tabelën me rezultatet dhe emrat e personave të zgjedhur Kryetar Bashkie dhe anëtarë të këshillit, për efekt të konstituimit të këshillit dhe shpalljes së vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të Bashkisë.
 6. Në rast se sekretari është i pamundur të jetë i pranishëm në mbledhjen e parë të këshillit, ai njofton me shkresë Prefektin së paku tre ditë pune përpara datës së mbajtjes së mbledhjes. Në këtë rast sekretari e shoqëron shkresën drejtuar Prefektit me dokumentacionin ligjor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe tabelat e rezultateve dhe emrat e personave të zgjedhur, si atë të Kryetarit të Bashkisë ashtu edhe anëtarëve të Këshillit.
 7. Sekretari, apo në mungesë të tij Prefekti, i shpërndan çdo këshilltari të pranishëm në mbledhjen e parë, një kopje të listës me emrat e këshilltarëve të konfirmuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, datëlindjet e tyre përkatëse dhe partinë politike që përfaqëson secili prej tyre sipas listës zgjedhore. Në rast se sekretari i këshillit apo Prefekti nuk janë të pranishëm në mbledhjen e parë që kanë thirrur, mbledhjen e parë e drejton këshilltari më i vjetër në moshë sipas listës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 8. Në rast se sekretari i këshillit apo Prefekti nuk e ushtrojnë të drejtën e thirrjes së mbledhjes së parë të këshillit dhe për këtë arsye mbledhja e këshillit nuk mbahet brenda afatit 20 ditor të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, atëherë, këshilli mbledhet vetë brenda 10 ditëve pas mbarimit të afatit 20 ditor. Grupit nismëtar i këshilltarëve që thërrasin mbledhje e parë janë përgjegjës për njoftimin e mbledhjes së parë dhe nisma bashkë me listën me emrat dhe me nënshkrimet e tyre bëhet publike në një mjedis publik në qendër të qytetit ose aty ku ndodhet salla e këshillit bashkiak. Në këtë rast grupi nismëtar njofton më shkrim Kryetarin në detyrë të Bashkisë, Kryetarin e zgjedhurat Bashkisë dhe Prefektin dhe së bashku me një kopje të listës së nënshkruar të nismëtarëve, ua dërgon atyre edhe njoftimin me orën, datën dhe vendin ku do të mbahet mbledhja e parë. Në çdo rast, personi që kryeson listën e këshilltarëve, nismëtarë të mbajtjes së mbledhjes së parë, bën njoftimin publik të mbledhjes së parë së paku tre ditë pune para mbajtjes së mbledhjes, në një zonë qendër të qytetit ose vendin ku ndodhet salla e Këshillit Bashkiak, si dhe në media audiovizive vendore.
 9. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrje nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, këshilli konsiderohet i shpërndarë, dhe sekretari e shpall këtë në këndin e njoftimeve për publikun të bashkisë, njofton Prefektin dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si dhe median vendore. Në rast se të treja mbledhjet i thërret Prefekti ose grupi nismëtar, këto të fundit shpallin shpërndarjen e këshillit në këndin e njoftimeve për publikun të bashkisë, si dhe njoftojnë Këshillin e Ministrave, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe median vendore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Neni 11
Mbledhja parë e Këshillit

1. Deklarimi i hapjes së Mbledhjes së Parë të Këshillit bëhet nga sekretari i këshillit dhe, në mungesë të tij, nga Prefekti, apo në mungesë të tyre, nga këshilltari më vjetër në moshë i grupit nismëtar të Mbledhjes së Parë, i cili ka marrë mandatin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe është i pranishëm në Mbledhje.
2. Sekretari ose Prefekti, apo kryesuesi i mbledhjes, lexon me zë të lartë listën e emrave të këshilltarëve të miratuar nga Komisionit Qendror i Zgjedhjeve dhe datëlindjet e tyre, dhe fton këshilltarin më të vjetër në moshë, sipas listës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që është i pranishëm në mbledhje, të drejtojë mbledhjen deri në zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit.
3. Në mbledhjen e parë:
 - a. Këshilli zgjedh Komisionin e Mandateve;
 - b. Këshilli miraton mandatet e këshilltarëve;
 - c. Këshilltarët e mandatuar bëjnë betimin;
 - d. Këshilli zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit;
 - e. Bëhet shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë dhe më pas Kryetari i Bashkisë bën betimin;
 - f. Kryetari i Bashkisë mban fjalën përshëndetëse përpara Këshillit;
 - g. Këshilli zgjedh këshilltarët që do të përfaqësojnë këshillin në këshillin e qarkut dhe i pajis ata me mandatin e përfaqësimit të anëtarit të këshillit të Qarkut.
4. Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të këshillit të shpallur fitues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
5. Nëse pas thirrjes së parë të mbledhjes së parë, nuk mblidhen më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit, sipas listës së Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret nga i njëjti subjekt që ka bërë thirrjen e parë (Sekretari i Këshillit, Prefekti apo 1/3 e Këshilltarëve të sapozgjedhur), në konsultim me kryetarin e sapo zgjedhur të bashkisë, tri ditë më vonë, por nuk thirret më shumë se tri herë. Thirrja shpallet në këndin e njoftimeve për publikun të Bashkisë dhe njoftohet në median audiovizive vendore¹⁵. Në pamundësi të sekretarit dhe kur thirrja bëhet nga Prefekti, njoftimi në median audiovizive vendore bëhet nga bashkia dhe nga Prefekti.
6. Mbledhja e parë e Këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë dhe i pranishëm në mbledhje.
7. Mbledhja e konstituimit të këshillit, në asnjë rast, nuk është mbledhje e mbyllur dhe sekretari apo Prefekti, grupi nismëtar i këshilltarëve të sapo zgjedhur që thërret mbledhjen e parë, fton median audiovizive vendore të marrë pjesë në mbledhje dhe koordinon transmetimin e saj direkt në të.
8. Mbledhja e Parë e Këshillit mbahet në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak. Kur kjo është e pamundur mbahet, sipas kësaj renditje, në një sallë të godinës së Prefekturës, në një sallë të një institucioni ose agjencie që është në varësi të Bashkisë dhe që ndodhet në qytetin ku ndodhet sallat e këshillit bashkiak, e kur edhe kjo është e pamundur atëherë mbahet në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

një godinë në qendër të qytetit apo të njësisë administrative ku ndodhet salla e këshillit bashkiak.

Neni 12

Komisioni i verifikimit të mandateve

1. Komisioni i Mandateve përbëhet nga 3 këshilltarë, dhe pasqyron për sa është e mundur përbërjen politike të Këshillit dhe përfaqësimin gjinor. Propozimet për përbërjen dhe Kryesinë e Komisionit bëhen nga Këshilltarët që deklarojnë publikisht përfaqësimin e partive politike.
2. Komisioni i Mandateve miratohet nga këshilli me votim të hapur, me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të mandatuar të këshillit.
3. Verifikimi i mandateve të këshilltarëve bëhet nga komisioni i Verifikimit të Mandateve, para se këshilltarët të bëjnë betim përpara këshillit.
4. Këshilltari më i vjetër në moshë i pranishëm në mbledhje, pasi merr kryesimin e mbledhjes së këshillit, kërkon ngritjen e komisionit të Verifikimit të Mandateve për verifikimin e mandateve të Këshilltarëve. Komisioni shqyrton dokumentacionin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe paraqet këshillit, brenda mbledhjes së parë të këshillit, raportin për vlefshmërinë e mandateve të këshilltarëve.
5. Nëse komisioni vëren paligjshmëri të dokumentacionit të dorëzuar nga Sekretari i Këshillit, Prefekti apo Këshilltarët e sapozgjedhur, dhe për këtë arsye nuk arrin të përgatisë raportin brenda Mbledhjes së Parë të Këshillit, i kërkon Kryesuesit të Mbledhjes shtyrjen e Mbledhjes për në ditën pasardhëse për të verifikuar dhe konsultuar dokumentacionin shtesë, shtyrje e cila publikohet nga Sekretari i Këshillit në mjediset e godinës së Bashkisë, në median audiovizive vendore dhe faqen zyrtare të internetit të Bashkisë nga Sekretari i Këshillit. Raporti miratohet nga të paktën dy nga tre anëtarët e Këshillit.
6. Në qoftë se mendimi për dhënien e mandatit një këshilltari nuk është unanim nga anëtarët e Komisionit të Mandateve, në raportin që përgatit Komisioni mendimi i shumicës shoqërohet me mendimin e pakicës.
7. Kryetari i Komisionit të Mandateve lexon me zë të lartë para Këshillit listën me emrat e Këshilltarëve me mandat të vlefshëm dhe deklaron numrin e Këshilltarëve me mandat të vlefshëm nga numri total i tyre. Kryesuesi i Mbledhjes fton këshilltarët e pranishëm të votojnë raportin e Komisionit të Verifikimit të Mandateve.
8. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak. Me vërtetimin nga Komisioni i Mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, dhe me miratimin e raportit të Komisionit të Mandateve me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të pranishëm në Mbledhje, kryesuesi i mbledhjes shpall konstituimin e këshillit bashkiak. Më pas këshilltarët me mandat të vlefshëm zënë vend në sallën e Këshillit Bashkiak.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Neni 13

Papajtueshmëria me funksionin e këshilltarit

1. Funksioni i Këshilltarit është i papajtueshëm me:
 - a. funksionin e Kryetarit dhe zëvendës kryetarit të bashkisë;
 - b. funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;
 - c. funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
 - d. funksionin e deputetit;
 - e. funksionin e ministrit;
 - f. funksionin e punonjësit të sekretariatit të këshillit.
2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak.
3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur si, bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrrë e vjehrra me nusen e dhëndrin.

Neni 14

Betimi i Këshilltarëve

1. Pas verifikimit të mandateve nga Komisioni i Mandateve, dhe miratimit të raportit të komisionit nga këshilli, këshilltarët me mandat të vlefshëm bëjnë këtë betim para këshillit: *“Betohe me në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Kamëz dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.*
2. Teksti i betimit lexohet nga kryesuesi i mbledhjes dhe këshilltarët ftohen, një e nga një, të ngrihen në këmbë dhe të deklarojnë “Betohe me”. Çdo këshilltar nënshkruan tekstin e betimit.
3. Këshilltari që mungon në mbledhjen e parë të këshillit dhe për këtë shkak nuk bën betimin, betohet në mbledhjen e radhës së këshillit. Këshilltari që nuk merr pjesë në mbledhjen e këshillit dhe nuk bën betimin as në mbledhjen e tretë radhazi të këshillit, konsiderohet se jep dorëheqjen nga mandati i këshilltarit dhe nuk i jepet mandati.
4. Njoftimi për arsyet e mungesës së këshilltarit në bërjen e betimit, në mbledhjen e parë të Këshillit, i drejtohet me shkrim sekretarit të këshillit dhe Prefektit, të cilët në varësi se kush thërret mbledhjen e parë, ia vënë në dispozicion të Komisionit të Mandateve.
5. Komisioni i Mandateve shqyrton rastin e këshilltarit që nuk bën betimin sipas pikës 3 të këtij neni, dhe i propozon mbledhjes së këshillit refuzimin e dhënies së mandatit të këshilltarit, dhe shpalljen e vendit vakant. Këshilli me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit vendos për refuzimin e dhënies së mandatit për këshilltarin dhe i njofton vendimin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Prefektit. Nëse këshilli nuk e miraton refuzimin e dhënies së mandatit, kryetari i këshillit dhe/apo sekretari njoftojnë zyrtarisht Prefektin dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Neni 15

Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të këshillit

1. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen nga radhët e anëtarëve të këshillit me votim të fshehtë dhe me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen, si dhe duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, për të garantuar përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini në organet drejtuese dhe respektimin në mënyrë të njëjtë për secilën gjini të procedurave dhe kritereve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe.
2. Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Bashkiak, zgjidhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Propozimi për shkarkimin e tyre, bëhet nga të paktën një treta e anëtarëve të këshillit.
3. Sekretari njofton fillimin e procedurës së zgjedhjes së kryetarit.
4. Kandidati për kryetar propozohet nga të paktën 10 këshilltarë. Një këshilltar nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat. Propozimi bëhet me shkrim, përmban nënshkrimet përkatëse dhe i paraqitet sekretarit.
5. Pas propozimeve përkatëse sipas parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, sekretari pyet kandidatin nëse e pranon kandidimin. Me marrjen e pëlqimit të kandidatit, sekretari shpall mbylljen e procesit të paraqitjes së kandidaturave.
6. Sekretari përgatit dhe bën publike para këshillit listën sipas renditjes së rendit alfabetik të kandidatëve.
7. Për ndjekjen e procedurave të votimit, kur kemi më shumë se një kandidat, këshilli me votim të hapur ngre komisionin e votimit. Komisioni përbëhet nga një numër tek anëtarësh dhe çdo kandidat mund të propozojë një këshilltar për të qenë pjesë e komisionit. Komisioni zgjedh nga radhët e tij kryetarin.
8. Gjatë votimit, sekretari deklaron mbylljen e dyerve të sallës së mbledhjes.
9. Nëse ka dy ose më shumë kandidatë për zgjedhjen e kryetarit, fletët e votimit përgatiten nga Sekretari dhe Komisioni i Votimit dhe i shpërndahen Këshilltarëve të pranishëm në Mbledhje.
10. Nuk bëhet debat për zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarëve të këshillit.
11. Procesi i numërimit të votave bëhet menjëherë, i hapur dhe votat deklarohen me zë nga kryetari i komisionit të votimit.
12. Kryetari shpallë numrin e fletëve të votimeve të hedhura, numrin e fletëve të votimit të pavlefshme dhe numrin e votave që kërkohen për të arritur 50 për qind plus një të shumicës.
13. Kur kandidatët nuk sigurojnë shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit (50%+1), votimi ribëhet midis dy kandidaturave që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast, fitues shpallet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave "Pro", dhe nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short. Shorti drejtohet nga kryetari/drejtuesi i mbledhjes së këshillit në bashkëpunim me sekretarin.
14. Kryetari i komisionit njofton para këshillit zgjedhjen e kandidatit fitues si kryetar të këshillit.
15. Në çdo kohë pasi të jetë shpallur rezultati i votimit të parë, por para fillimit të një votimitë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- dytë ose të mëvonshëm, një kandidat mund të tërhiqet nga zgjedhjet, në të cilat më pas do të procedohet sikur ai kandidat të mos ishte emëruar si i tillë.
16. Kryetari i zgjedhur i këshillit merr drejtimin e mbledhjes menjëherë pas shpalljes së rezultatit nga komisioni i votimit. Kryesuesi i mbledhjes fton menjëherë kryetarin e këshillit të zërë vendin e tij.
 17. Kryetari i sapozgjedhur i këshillit merr drejtimin e mbledhjes dhe shpall fillimin e procedurave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të këshillit.
 18. Këshilli ka të paktën dy zëvendëskryetarë. Njëri nga zëvendëskryetarët duhet t'i përkasë partisë më të madhe të pakicës në këshill, i cili propozohet nga Këshilltarët.
 19. Mbi 30% e listës e kandidatëve për kryetar, zëvendëskryetar dhe sekretar të këshillit duhet t'i përkasë së njëjtës gjini.
 20. Në fillim bëhet votimi për kryetarin e më pas për zëvendëskryetarët.
 21. Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve ndiqen të njëjtat procedura si ato për zgjedhjen e kryetarit. Këshilli bën votim të veçantë për secilin prej zëvendëskryetarëve. Në fillim bëhet votimi për zëvendëskryetarin që propozohet nga grupi i këshilltarëve të pakicës më të madhe, dhe më pas votimi për zëvendëskryetarin që propozohet nga grupi i shumicës politike.
 22. Nëse pas përfundimit të procesit të votimit, kryetari i zgjedhur dhe zëvendëskryetari nga radhët e këshilltarëve të opozitës më të madhe i takojnë të njëjtës gjini, zëvendëskryetari i shumicës duhet të zgjidhet nga gjinia tjetër.
 23. Në rast se vendi i sekretarit të këshillit është vakant, atëherë rolin e tij sipas parashikimeve të këtij neni e kryen komisioni i votimit i ngritur për këtë qëllim.

Neni 16
Sekretari i këshillit

1. Sekretari i Këshillit emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i Sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit.
2. Në mbledhjen e tij të parë këshilli nuk mund të marrë vendim për emërimin apo shkarkimin e sekretarit.
3. Vendimi për shkarkimin e sekretarit në mbledhjen e parë të këshillit bëhet vetëm në rastin kur sekretari nuk organizon mbledhjen e konstituimit të këshillit pa asnjë arsye objektive dhe pa njoftuar paraprakisht me shkrim Prefektin dhe Kryetarin e Bashkisë në detyrë.
4. Në rast se sekretari ka depozituar kërkesën për dorëheqje nga funksioni, këshilli në mbledhjen e tij të parë merr vendim për lirimin e tij nga detyra dhe vendos për fillimin e procedurave për emërimin e sekretarit të ri.

Neni 17
Mandati i Kryetarit të Bashkisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

1. Shpallja e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë dhe betimi i tij bëhet në mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak menjëherë pas konstituimit të këshillit. Kryetari i sapozgjedhur i këshillit pas shpalljes së vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë, lexon formulën e betimit, sipas përcaktimeve në nenin 50 të ligjit 139/2015.
2. Nëse Këshilli nuk konstituohet, Prefekti organizon ceremoninë e betimit të Kryetarit të Bashkisë në mjedisin e Bashkisë dhe në praninë e banorëve të saj.
3. Në rast se, Kryetari i sapozgjedhur i Bashkisë merr pjesë në mbledhjen e parë të Këshillit dhe refuzon të bëjë betimin dhe të nënshkruajë formulën e betimit, apo nuk merr pjesë në mbledhjen e parë të Këshillit për të bërë betimin, pa i paraqitur më parë me shkrim këshillit arsyet objektive të mospjesëmarrjes, këshilli me vendim të shumicës së të gjithë këshilltarëve të mandatuar dhe pjesëmarrës në mbledhjen e parë deklaronë se Kryetari i Bashkisë ka refuzuar bërjen e betimit dhe si rezultat shpall mbarimin para afatit të mandatit të Kryetarit të Bashkisë dhe nëpërmjet Prefektit njofton Këshillin e Ministrave, për përfundimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë përpara afatit. Kryetari i sapozgjedhur i këshillit, drejton votimin i asistuar nga Sekretari.
4. Deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri të Bashkisë, funksionet e tij i kryen zëvendëskryetari bashkisë. Në rastet kur këshilli bashkiak ka më shumë se një zëvendëskryetar bashkie, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, cakton një prej zëvendës kryetarëve të kryejë funksionet e kryetarit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Nëse Bashkia ka më shumë se një zëvendëskryetar, të gjithë zëvendëskryetarët përfshihen në listën e votimit. Në rast se votimi del i barabartë mes dy zëvendëskryetarëve, këshilli hedh short përtë përcaktuar fituesin. Shorti drejtohet nga kryetari i këshillit i cili bën edhe shpalljen e fituesit. Votimi në këtë rast bëhet i fshehtë.

Neni 18

Zgjedhja e përfaqësuesve të Këshillit të Qarkut

1. Përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak në Këshillin e Qarkut zgjidhen mes anëtarëve të Këshillit, me votim të fshehtë të listës shumë emërore dhe shpall fitues kandidatin ose kandidatët që kanë marrë shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Në rast se ka barazim votash, ribëhet votim vetëm për kandidatët që kanë barazim votash dhe shpallet fitues kandidati që ka marrë më shumë vota. Nëse ka barazim votash sërish, fituesi caktohet me short. Shorti drejtohet nga kryetari/kryesuesi i mbledhjes.
2. Të drejtën për të propozuar një kandidat për përfaqësues në këshillin e qarkut e ka çdo Këshilltar apo grup politik këshilltarësh.
3. Përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut në jo më pak se 50% të tyre duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar në këshillin bashkiak.
4. Këshilltari që është zgjedhur përfaqësues në këshillin e qarkut, në rastin e përfundimit të mandatit si këshilltar bashkiak përfundon edhe mandatin si anëtar i këshillit të qarkut. Në këtë rast bëhet zëvendësimi i tij, duke ruajtur raportin e përcaktuar për barazinë gjinore
5. Kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit, nuk mund të zgjidhen anëtarë të këshillit të qarkut.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Neni 19

Mbarimi i mandatit të këshilltarit

1. Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:
 - a. ndryshon vendbanimin dhe regjistrohet si banor jashtë territorit të bashkisë Kamëz;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 139/2015;
 - d. mandati nga ana e tij është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
 - e. humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykate;
 - f. ndërron jetë;
 - g. nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6 mujore;
 - h. dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;
 - i. këshilli shpërndahet nga Këshilli i Ministrave.
 - j. konstatohen kushtet për zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 139/2015, neni 13 dhe shpallet publikisht rezultati i verifikimit nga autoriteti i verifikimit, mandati i këshilltarit përfundon menjëherë.
2. Anëtari i këshillit të cilit i është konstatuar kushti ndalues, pezullohet nga ushtrimi i funksionit për efekt të ligjit dhe Këshilli, në përputhje me ligjin nr. 139/2015, mund të vendosë t'i heqë mandatin.
3. Kryetari i këshillit, një grup prej jo më pak se tre këshilltarësh dhe kryetari i Komisionit të Mandateve mund t'i propozojnë komisionit të mandateve shqyrtimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit.
4. Propozimi paraqitet me shkrim, dhe duhet të përmbajë shkaqet ligjore për mbarimin e mandatit, dhe kur është e mundur dhe provat përkatëse. Propozimi depozitohet pranë sekretarit të këshillit. Sekretari njofton me shkrim kryetarin e Komisionit të Mandateve dhe këshilltarin për të cilin propozohet mbarimi i mandatit.
5. Kryetari i Komisionit të Mandateve është i detyruar të thërrasë mbledhjen e komisionit brenda 7 ditëve nga data e marrjes së propozimit.
6. Propozimi i Komisionit të Mandateve për mbarimin e mandatit, së bashku me dokumentet që provojnë shkaqet e mbarimit të mandatit për këshilltarin, i paraqiten për diskutim dhe vendimmarrje këshillit bashkiak në mbledhjen më të afërt.
7. Komisioni i Mandateve brenda 5 ditëve nga data e mbledhjes së Komisionit ku është diskutuar kërkesa për mbarimin e mandatit të këshilltarit, njofton këshilltarin për të paraqitur pretendimet e tij. Brenda 10 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit nga Komisioni i Mandateve, këshilltari dërgon në komisionin e Mandateve arsyetimin ose fakte që kundërshtojnë mbarimin e mandatit. Në qoftë se këshilltari nuk dërgon arsyetimin ose fakte e tij brenda këtij afati 10 ditor atëherë komisioni merr vendim dhe ia kalon për shqyrtim dhe miratim këshillit Bashkiak.
8. Nëse Komisioni i Mandateve nuk i dërgon këshillit, brenda 20 ditëve nga marrja e propozimit, raportin e miratuar në lidhje me propozimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit atëherë, propozuesi ka të drejtë t'i dërgoj këshillit, jo më vonë se 5 ditë nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- mbarimi i këtij afati, propozimin me dokumentet dhe shkaqet ligjore për mbarimin e mandatit të këshilltarit. Në këtë rast këshilli ka detyrimin ta shqyrtojë propozimin në mbledhjen e tij të parë nga marrja e propozimit.
9. Vendimi i këshillit për mbarimin e mandatit të këshilltarit përmban mendimin e shumicës dhe pakicës.
 10. Vendimi i këshillit bashkiak për mbarimin e mandatit i njoftohet këshilltarit brenda 5 ditëve dhe vendin e tij e zë kandidati i radhës në listën shumë emërore të subjektit politik ku bënte pjesë. Zëvendësimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
 11. Nëse Këshilli nuk merr në shqyrtim apo nuk merr vendim për propozimin e Komisionit të Mandateve apo të këshilltarëve të përmendur në pikën “e” më sipër, për konstatimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, Sekretari njofton me shkrim Prefektin.
 12. Mbarimi para kohe i mandatit të këshilltarit deklarohet me vendim të këshillit, me propozim të Komisionit të Mandateve.
 13. Heqja e mandatit të këshilltarit bëhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.
 14. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij kur propozohet heqja e mandatit të tij.
 15. Në rastin kur këshilltari mungon për 6 muaj rresht në mbledhjet e këshillit, sekretari i paraqet me shkrim kryetarit të këshillit raportin ku pasqyrohen datat e mungesave, dhe ky i fundit ia përcjell raportin Komisionit të Mandateve bashkë me kërkesën. Propozimi për heqjen e mandatit paraqitet nga Komisioni i Mandateve në mbledhjen e parë të rregullt të radhës së Këshillit. Në çdo rast, Kryetari i Këshillit bën përpjekje për të kontaktuar me këshilltarin për të kuptuar arsyet e mungesave.
 16. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij kur propozohet heqja e mandatit të tij.
 17. Në rastin kur këshilltari mungon për 6 muaj rresht në mbledhjet e këshillit, sekretari i paraqet me shkrim kryetarit të këshillit raportin ku pasqyrohen datat e mungesave, dhe ky i fundit ia përcjell raportin Komisionit të Mandateve bashkë me kërkesën. Propozimi për heqjen e mandatit paraqitet nga Komisioni i Mandateve në mbledhjen e parë të rregullt të radhës së Këshillit. Në çdo rast, Kryetari i Këshillit bën përpjekje për të kontaktuar me këshilltarin për të kuptuar arsyet e mungesave.

Neni 20
Të drejtat e këshilltarit

1. Këshilltari përfiton të gjithë të drejtat e parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 139/2015.
2. Këshilltari nuk përgjigjet për mendime të shprehura, lidhur me çështje zyrtare gjatë ushtrimit të detyrës.
3. Këshilltari shpërblehet për punën që kryen. Masa e shpërblimit vendoset nga këshilli mbi bazën e kritereve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
4. Këshilltari ka të drejtën e kualifikimit profesional, sipas programit të miratuar nga këshilli. Financimi në këto raste bëhet sipas legjislacionit përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Neni 21
Konflikt interesi

1. Këshilltari nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e projektaktit të këshillit, kur aivëtë ose bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehrrri, vjehrra, dhëndëri e nusjæe tij, kanë interes pasuror, ose çdo interes tjetër me çështjen që diskutohet në këshill.
2. Në çdo rast konflikti interesash, zbatohen dispozitat skualifikuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave.

Neni 22
Mandati dhe mbledhjet e këshillit bashkiak

1. Këshilli ushtron funksionet e tij nga krijimi deri në kostituimin e këshillit të ri, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 139/2015.
2. Mbledhjet e radhës të këshillit bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bënvetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj.
3. Këshilli mblidhet jashtë radhe:
4. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë;
5. Me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të tij;
6. Me kërkesën e motivuar të Prefektit, për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij.
7. Thirrja për mbledhjen e këshillit, bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.
8. Në rast situatash emergjente, njoftimi mund të bëhet jashtë afatit të përcaktuar në pikën
9. 4 të këtij neni dhe këshilli vendos për miratimin e rendit të ditës me shqyrtimin e projektakteve që vlerësohen të tilla.
10. Rendi i ditës miratohet nga këshilli.
11. Në periudhën nga data e zgjedhjeve, deri në kostituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm ushtron funksione të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.
12. Mbledhja e Këshillit quhet e vlefshme, kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 55 të ligjit nr. 139/2015.
13. Kur Këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetë shpërndarë. Vetë shpërndarja, pasohet me zgjedhje të reja për Këshillin dhe Sekretari i Këshillit brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3 mujor, njofton Prefektin.
14. Mbledhjet e këshillit bashkiak pasqyrohen në procesverbal, i cili mbahet sipas nenit 57të kësaj rregulloreje.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Neni 23

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak

1. Këshilli, ushtron të gjithë detyrat dhe funksionet e parashikuara në nenin 54 të ligjit nr. 139/2015, si edhe të gjitha ato kompetenca dhe detyra sipas përcaktimeve të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.
2. Këshilli merr vendime edhe për çështje që nuk i ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me një ligj një organi tjetër.

KREU III

KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Neni 24

Kryesia e Këshillit Bashkiak

1. Kryesia e këshillit përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i këshillit. Kryesia, kur e gjykon të nevojshme, fiton në mbledhje të zgjeruar të saj edhe drejtuesit e grupeve të këshilltarëve, si dhe përfaqësuesin e organit ekzekutiv.
2. Kryesia, është organ konsultativ që kujdeset për mbarëvajtjen e punës së këshillit, gjatë dhe midis dy mbledhjeve të tij.
3. Kryesia, përgatit projekt tematikën e çështjeve që do të shqyrtojë këshilli bashkiak në periudha vjetore, 3 mujore dhe mujore, mbi bazën e propozimeve të organit ekzekutiv, të grupeve të këshilltarëve, të komisioneve dhe e paraqet për miratim në mbledhjen e tij.
4. Kryesia, mbikëqyr dhe ndihmon mbarëvajtjen e veprimtarisë së komisioneve të përhershme dhe të përkohshme të këshillit.
5. Kryesia, në konsultim me komisionin që ndjek çështjet jashtme dhe atë të çështjeve juridike, organizon marrëdhëniet me këshilla bashkiakë të tjerë, brenda dhe jashtë vendit.
6. Kryesia, në konsultim me drejtuesit e grupeve të këshilltarëve, përcakton përfaqësuesit në marrëdhëniet me këshilla bashkiakë të tjerë, brenda dhe jashtë vendit dhe njofton këshillin bashkiak në mbledhjen e afërt të tij.

Neni 25

Kryetari i Këshillit

1. Kryetari i Këshillit kryen këto detyra:
 - a. Thërret mbledhjen e këshillit në përputhje me nenin 53 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.
 - b. Drejton mbledhjet e këshillit në përputhje me rregulloren e tij.
 - c. Merr masa për zhvillimin e mbledhjeve dhe ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë gjatë zhvillimit të saj.
 - d. Jep masat disiplinore sipas parashikimeve në këtë rregullore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- e. Nënshkruan aktet që nxjerr këshilli.
 - f. U bën të njohur këshilltarëve projektaktet që i paraqiten këshillit.
 - g. Përfaqëson këshillin në veprimtari të ndryshme të qytetit.
 - h. Shpall rendin e ditës, për mbledhjen e ardhshme dhe njofton zyrtarisht organin ekzekutiv për paraqitjen e materialeve sipas tematikës së miratuar.
2. Në rast se kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, ai autorizon një nga zëvendëskryetarët për kryerjen e tyre. Në mungesë të autorizimit, ai zëvendësohet nga zëvendëskryetari i këshillit bashkiak që i përket shumicës në këshill.
 3. Kryetari në veprimtarinë e tij në këshill, asistohet nga një sekretar.

Neni 26
Sekretari i këshillit

1. Sekretari i këshillit, emërohet dhe shkarkohet nga këshilli, me propozim të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Shkarkimi i sekretarit, mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.
2. Sekretari i këshillit bashkiak përveç detyrave të përcaktuara në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, kryen edhe këto detyra:
 - a. Koordinon punën për hartimin e rendit të ditës së mbledhjes në bashkëpunim me kryetarin e këshillit;
 - b. Koordinon përgatitjen e materialet për mbledhjen e Këshillit dhe kujdeset për shpërndarjen për çdo anëtar të këshillit;
 - c. Njofton këshilltarët, median dhe publikun për zhvillimin e mbledhjes së këshillit;
 - d. Mban procesverbalin e mbledhjes dhe mundëson regjistrimin e mbledhjes së këshillit;
 - e. Është përgjegjës për operimin, mbarëvajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve që mundësojnë regjistrimin audio-video të mbledhjes së Këshillit dhe të Komisioneve të Përhershme;
 - f. Ndihmon kryetarin e këshillit gjatë zhvillimit të mbledhjeve të këshillit;
 - g. Ndjek nënshkrimin e procesverbalit të mbledhjes;
 - h. Mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
 - i. Ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve sipas rendit të ditës;
 - j. Kujdeset për bazueshmërinë ligjore të akteve, që kalojnë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit;
 - k. Shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak;
 - l. Përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
 - m. Mbikëqyrjen e respektimit të Rregullores së brendshme të funksionimit të këshillit;
 - n. Vërtetimin e saktësisë dhe të nënshkrimit të protokollit të mbledhjeve të këshillit;
3. Sekretari i këshillit, kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga këshilli.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

**Neni 27
Sekretaria e këshillit**

1. Rolin e sekretarisë së këshillit, e kryen sekretaria e kryetarit të këshillit.
2. Sekretaria, kryen këto detyra:
 - a. Njofton kryetarin e këshillit për pjesëmarrjen e këshilltarëve në mbledhje;
 - b. Lexon tekstet e projekteve që i janë paraqitur këshillit, nëse një gjë e tillë gjykohet e nevojshme;
 - c. Numëron votat e këshilltarëve që marrin pjesë në votim të hapur dhe i njofton Kryetaritrezultatit e tij;
 - d. Mban procesverbalin e mbledhjes së këshillit;
 - e. Kryen edhe detyra të tjera që lidhen me mbarëvajtjen e këshillit që i ngarkohen ngakryetari i këshillit.

**KREU IV
GRUPIMET E KËSHILLTARËVE**

**Neni 28
Grupet e këshilltarëve**

1. Këshilltarët mund të grupohen në përputhje me orientimin e tyre politik. Këshilltari mund të marrë pjesë vetëm në një grupim politik.
2. Këshilltarët nuk mund të formojnë grupim mbi bazë interesash etnike.
3. Formimi i grupeve të këshilltarëve, si rregull, bëhet brenda 2 muajve nga konstituimi i Këshillit Bashkiak.
4. Numri minimal për formimin e një grupi është 3 këshilltarë.

**Neni 29
Kushtet për anëtarësimin në grup**

1. Kushtet për anëtarësimin në grup, për largimin nga grupi, të drejtat dhe detyrat e tyre brenda grupit, përcaktohen nga vetë grupi i këshilltarëve.
2. Çdo grupim politik, paraqet tek kryetari i këshillit, listën e anëtarëve, kryetarin dhe zëvendëskryetarin e tij.
3. Në mbledhjen e afërt të këshillit, kryetari shpall përbërjen e grupit dhe drejtuesit e tij.
4. Këshilltari, mund të largohet nga një grup, duke e deklaruar atë në mbledhjen e grupitdhe të këshillit. Në këtë rast duhet të shprehet edhe drejtuesi i grupit ku ai kërkon të bëj pjesë.
5. Ndryshimet në grupet e këshilltarëve dhe të drejtuesve të tyre, i bëhen të ditur kryetarit të këshillit dhe regjistrohen nga sekretaria.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Neni 30

Mbledhjet e grupeve të këshilltarëve

1. Mbledhjet e grupeve të këshilltarëve, zhvillohen mbi bazën e rregullave të organizimit të tyre të brendshëm.
2. Grupet e këshilltarëve, mund t'i zhvillojnë mbledhjet e tyre në mjediset e këshillit. Sekretari i këshillit, merr masa për sigurimin e mjediseve të përshtatshme duke koordinuar më parë me drejtuesit e grupit.

KREU V

KOMISIONET E KËSHILLIT

Neni 31

Komisionet e përhershme

1. Këshilli Bashkiak ka këto komisione të përhershme:
2. Këshilli për kryerjen e funksioneve të tij, krijon komisione të përhershme e të përkohshme.
3. Komisionet kryejnë detyra për njohjen dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fusha të ndryshme të veprimtarisë së Këshillit Bashkiak.
4. Numri dhe përbërja emërore e anëtarëve të komisioneve, miratohet nga këshilli me votim të hapur, me propozim të kryetarit të këshillit, pas konsultimeve me kryetarët e grupeve.
5. Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i këshillit bashkiak, nuk bëjnë pjesë në përbërjen e komisioneve.
6. Komisioni i Mandateve, Rregulloreve dhe Çështjeve juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare;
7. Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve;
8. Komisioni i Financave, Ekonomisë Vendore, Buxhetit, Turizmit, Zhvillimit Rural, Pasurive Bashkiake, Planifikimit, Zhvillimit Strategjik, Mbikqyrjes financiare, Shërbimeve Publike, Transportit, Parqeve e Rekreacionit, Parkingjeve, Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit;
9. Komisioni i sigurisë Publike, Shëndetësisë, Emergjencave civile, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
10. Komisioni i Arsimit, sporteve, Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut;
11. Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve;
12. Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujërave dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
13. Qeverisë elektronike, Teknologjisë dhe Informacionit;
14. Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit European.

Neni 32

Drejtuesit e komisioneve të përhershme

1. Kryesia e komisionit përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit, të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- cilët zgjidhen nga këshilltarët, sipas formulës së miratuar në konsultimet me kryetarët e grupeve.
2. Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komisionit të përhershëm bëhet duke respektuar kërkesat e ligjit për barazinë gjinore. Anëtarët e Komisioneve, së bashku me kryesitë e tyre, zgjidhen me votim të hapur nga Këshilli.
 3. Kryetari i komisionit përfaqëson komisionin, organizon dhe drejton mbledhjet e komisionit, mban lidhje me organet e tjera të këshillit, si dhe siguron respektimin e procedurave, sipas kësaj Rregulloreje.
 4. Drejtuesit e komisioneve të përhershme bashkërendojnë punën mes tyre, si dhe me kryesinë e këshillit për zgjidhjen e problemeve të caktuara.
 5. Në rast se kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari që i përket shumicës në këshill bashkiak.
 6. Kryetari i komisionit përfaqëson komisionin, organizon dhe drejton mbledhjet e komisionit, mban lidhje me organet e tjera, si dhe siguron respektimin e procedurave, sipas kësaj Rregulloreje.
 7. Sekretari verifikon rezultatin e votimit në komision dhe kontrollon e nënshkruan procesverbalin e përmbledhur të mbajtur në mbledhjen e komisionit.

Neni 33

Veprimtaria e komisioneve të përhershme

1. Veprimtaria e komisioneve të përhershme, bazohet në legjislacionin përkatës, në këtë rregullore dhe në rregulloret e funksionimit të tyre.
2. Komisionet e përhershme shqyrtojnë raporte, projekte, studime e relacione të Bashkisë, të ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi të saj dhe bëjnë vlerësimet përkatëse për to.
3. Komisionet e përhershme mund të hartojnë edhe vetë projektvendime, rregullore dhe urdhra të cilat shoqërohen me relacionet përkatëse.
4. Komisionet e përhershme mund të organizojnë edhe mbledhje të përbashkëta midis tyre, të cilat drejtohen nga një kryetar i pranuar me mirëkuptim.
5. Nëpunësit e administratës së Bashkisë, si dhe ato të ndërmarrjeve dhe institucioneve në vartësi të saj, janë të detyruar t'iu vënë në dispozicion këshilltarëve të dhënat që kërkojnë në përputhje me legjislacionin përkatës.
6. Komisionet, gjatë veprimtarisë së tyre, për çështje të caktuara, mund t'i propozojnë këshillit aktivizimin si ekspert të specialistëve të jashtëm.

Neni 34

Mbledhjet e komisioneve të përhershme

1. Komisionet e përhershme mblidhen nga kryetari ose zëvendëskryetari, me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të komisionit dhe me porosi të kryetarit të këshillit.
2. Mbledhja e një komisioni, quhet e vlefshme, kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- anëtarëve të tij.
3. Mbledhjet e komisioneve zhvillohen të hapura, me përjashtim të rasteve kur komisioni vendos ndryshe.
 4. Komisionet, brenda fushave përkatëse të përgjegjësisë kanë të drejtë të kërkojnë pjesëmarrjen në mbledhjen e komisionit të drejtorëve të përgjithshëm dhe drejtorëve të administratës së Bashkisë, si dhe të drejtuesve të institucioneve, ndërmarrjeve apo agjencivenë varësi të bashkisë, për të dhënë shpjegime për projektaktet apo sqarime dhe informacione për çështje probleme të fushave, ku ata janë individualisht përgjegjës, si dhe për çështje që kanë të bëjnë me aktet, politikat, strategjitë dhe planet e miratuara nga këshilli.
 5. Komisioni, pasi shqyrton projektaktet e paraqitura, përgatit një relacion, të cilin kryetari apo zëvendëskryetari, e paraqesin në mbledhjen e këshillit.
 6. Komisionet e përhershme, mbledhen në selinë e bashkisë, sipas një kalendari të përgatitur në bashkëpunim me kryetarin dhe sekretarin e këshillit.
 7. Në mbledhjet e komisioneve të përhershme, mbahet procesverbali i përmbledhur nga sekretaria e këshillit, i cili, pas verifikimit, nënshkruhet edhe nga drejtuesi i komisionit.
 8. Në procesverbalin e përmbledhur shënohet data e zhvillimit të mbledhjes, çështja që shqyrtohet, pjesëmarrja e këshilltarëve dhe e të ftuarve, përmbledhja e diskutimeve të bëra, qëndrimet e këshilltarëve dhe rezultati i votimit. Procesverbali i përmbledhur paraqitet në mbledhjen më të parë pasardhëse të komisionit. Në rast se në mbledhjen e komisionit nuk ka vërejtje për procesverbalin e mbledhjes paraardhëse, procesverbali quhet i pranuar.

Neni 35

Komisionet e përkohshme

1. Këshilli bashkiak, mund të krijojë edhe komisione të përkohshme pune studimore ose për përgatitje projektvendimesh në fusha të caktuara që i shërbejnë interesit publik vendor.
2. Propozimi për krijimin e tyre, mund të bëhet nga së paku 10 këshilltarë, ose nga një grup këshilltarësh. Komisionet e përkohshme krijohen kur votojnë pro shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit.
3. Mënyra e krijimit dhe e funksionimit të tyre, është e njëjtë me atë të komisioneve të përhershme.
4. Kohëzgjatja e veprimtarisë, përcaktohet në aktin e krijimit të tyre, por në çdo rast nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

Neni 36

Kontrolli i brendshëm financiar

1. Me propozim të kryesisë dhe në konsultim me drejtuesit e grupeve, bazuar në legjislacionin në fuqi në fuqi, Këshilli vendos krijimin e një komisioni financiar, i cili përbëhet nga jo më pak se 3 këshilltarësh, ku shumica i takon shumicës në këshill.
2. Përfaqësues të organit ekzekutiv dhe nëpunës të administratës së tij, nuk mund të bëjnë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

pjesë në këtë komision.

3. Komisioni Financiar, funksionon gjatë gjithë periudhës së mandatit të këshillit.
4. Komisioni Financiar, kontrollon të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga organiekzekutiv në përputhje me buxhetin e miratuar nga këshilli.
5. Organi ekzekutiv i raporton komisionit në mënyrë periodike gjatë vitit dhe i dorëzon atijnjë kopje të dokumentacionit kontabël dhe financiar përkatës.
6. Komisioni Financiar, raporton në këshillin bashkiak, përfundimet që dalin nga kontrollete ushtruara dhe merr vendimin përkatës.
7. Komisioni Financiar, ka të drejtë të kërkojë auditim të jashtëm të llogarive me ekspertë kontabël të autorizuar, kur gjykon se është e nevojshme. Kontraktimi i të cilit kryhet sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI
FINANCIMI I AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT

Neni 37

Buxhetimi vjetor i shpenzimeve të Këshillit

1. Këshilli Bashkiak harton projektbuxhetin e vet mbi bazë performance dhe e përfshin çdo vit në linjën e vet buxhetore të buxhetin e Bashkisë, si dhe përcakton shpenzimet e veta në mbështetje të aktiviteteve të parashikuara në programin e tij të punës, të standardeve të punës së Këshillit dhe nevoja për ushtrimin e funksioneve të Këshillit.
2. Në këto shpenzime përfshihen pagat e shpërblimet për punonjësit e Sekretariatit të Këshillit, tëshpërblimeve të Këshilltarëve, shpenzimet për marrëdhëniet me publikun, pjesëmarrjen e publikut në politikëbërje dhe vendimmarrje dhe konsultimet me publikun; për mbështetje teknike e ekspertizë; për rritjen e kapaciteteve të Këshilltarëve dhe Sekretariatit; për shpenzimeoperative dhe investimet për përmirësimin e kushteve dhe mjediseve të punës; për pjesëmarrjepër vizita studimore, në konferenca e aktivitete të ngjashme; shpenzime për aktivitetet e përfaqësimit institucional të Këshillit, dhuratat, pritje të delegacioneve nga këshilla homologë; shpenzimet për botimet e Këshillit dhe blerjen e botimeve; për rimbursimet për shpenzimet e autorizuar; për anëtarësim në organizata profesionale apo ku përfaqësohet Këshillit, etj.

Neni 38

Miratimi i projektbuxhetit vjetor të këshillit

1. Sekretari i Këshillit i dorëzon secilit prej Këshilltarëve një kopje të projekt buxhetit të Këshillit Bashkiak.
2. Miratimi i buxhetit të Këshillit Bashkiak bëhet me votimin “Pro” të shumicës së këshilltarëve të pranishëm në mbledhje. Kryetari firmos projektbuxhetin dhe ia përcjell kryetarit të bashkisë përta përfshirë në projekt dokumentin e konsoliduar të buxhetit të Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Kryesia e Këshillit është përgjegjëse për planifikimin dhe ndjekjen e zbatimit të buxhetit të Këshillit. Kryetari i këshillit autorizon zbatimin, duke përfshirë shpenzime për politikat që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme të Këshillit. Sekretari i këshillit është përgjegjës për administrimin e buxhetit të këshillit dhe bashkëpunon me administratën e bashkisë për këtë qëllim.
4. Projekti paraprak i buxhetit të Këshillit dhe relacioni përkatës hartohen nga Sekretari në bashkëpunim kryesinë e Këshillit dhe specialistin e financës së Sekretariatit, si dhe në këshillim me drejtorin e buxhetit të Bashkisë. Projekt buxheti hartohet në reference të planit vjetor të punës së këshillit.
5. Sekretari ia paraqet projektin paraprak të buxheti për shqyrtim dhe miratim komisionit për buxhetin e Këshillit.
6. Projekt buxheti dhe relacioni përkatës firmoset nga kryetari dhe sekretari i këshillit, ky i fundit në pozicionin e drejtuesit të ekipit të menaxhimit të programi buxhetor të Këshillit.
7. Mbas shqyrtimit të projektit paraprak të buxhetit në Grupin e Menaxhimit Strategjik për Buxhetin e Bashkisë, kryetari e paraqet projekt buxhetin në mbledhjen e këshillit, për miratim.

Neni 39

Shpërblimi dhe rimbursimi i këshilltarëve

1. Këshilltarët shpërblehen çdo muaj për punën që kryejnë si anëtarë të këshillit. Masa e shpërblimit për çdo këshilltar është 10% e rrogës së kryetarit të bashkisë. Këshilli vlerëson mundësinë e shpërblimit shtesë për kryetarin e këshillit.
2. Anëtarët e këshillit marrin shpërblimin, për kohën e:
3. pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillit;
4. pjesëmarrjes në mbledhjet e komisioneve të këshillit, në të cilat këshilltari është zgjedhur anëtar;
5. përfaqësimit të bashkisë jashtë kufijve administrative të saj, kur ai është deleguar nga këshilli.
6. Pjesëmarrja e këshilltarëve në mbledhjet e këshillit dhe në mbledhjet e Komisioneve të Përhershëm dokumentohet nga Sekretari i Këshillit, mbi bazë të procesverbaleve të mbledhjeve. Sekretari mban regjistrin e përditësuar të pjesëmarrjes së Këshilltarëve në Mbledhjet e Këshillit dhe Komisioneve të Përhershëm të Këshillit, si dhe harton raportin përkatës tre mujor dhe e paraqet në mbledhjen e Këshillit.
7. Parimet e veçanta të shpërblimit për Këshilltarët, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 40

Raporti i shpenzimeve vjetore të Këshillit

1. Kryetari i këshillit harton raportin vjetor të shpenzimeve të buxhetit të Këshillit, në bashkëpunim me Sekretarin dhe drejtorinë e financave të Bashkisë.
2. Raporti shqyrtohet në Komisionin e Financës dhe Buxhetit dhe i paraqitet Këshillit për



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

miratim jo më vonë se muaji Prill të vitit pasardhës. Sekretari e bën publik raportin në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.

3. Buxheti i Këshillit nuk mund të përdoret për reklama.

**KREU VII
PARAQITJA E PROJEKT-AKTEVE DHE PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË
MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK**

Neni 41

Seancat e këshillimeve me bashkësinë

1. Përpara shqyrtimit të projektakteve, këshilli, grupet dhe komisionet, zhvillojnë seanca këshillimi me bashkësinë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
2. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme, për rastet e parashikuara në nenin 18, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k” të nenit 54 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.
3. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës që përcakton këshilli, duke përdorur një nga format si, takimet e hapura me përfaqësues të banorëve, me specialistë dhe institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare, ose nëpërmjet nismës për organizim referendumeve vendore. Projektaktet afishohen në vende publike dhe në faqen zyrtare të internetit për t’iu dhënë mundësi të gjithë grupeve të interesuara për tu njohur dhe shprehur opinionet dhe sugjerimet mbi projektaktet.
4. Problemet që dalin nga procesi i këshillimit, shqyrtohen në mbledhjet e komisioneve përkatëse dhe më pas diskutohen në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Neni 42

E drejta e publikut për t’u informuar

1. Aktet e këshillit afishohen në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të Bashkisë ose publikimi i tyre në faqen zyrtare të internetit.
2. Informimi i publikut bëhet sipas rregullave që cakton këshilli, bazuar në legjislacionin për të drejtën e informimit.

Neni 43

Përgatitja dhe propozimi i projektakteve në Këshillin Bashkiak

1. Kanë të drejtë të përgatisin dhe propozojnë projekt-akte në Këshillin Bashkiak:
2. Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit, grupet e këshilltarëve, komisionet e përhershme, si dhe çdo këshilltar.
3. Në përputhje me rendin e ditës të miratuar, kur propozues është Kryetari i Bashkisë,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- projektakti i paraqitet sekretarit të këshillit si rregull jo më vonë se 5 ditë përpara datës së mbledhjes së rradhës. Me përjashtim të akteve të parashikuara në nenin 41 pika 2 të kësaj rregullore, të cilat duhet të paraqiten si rregull të paktën 10 ditë para zhvillimit të mbledhjes.
4. Kur propozues të projektaketeve janë këshilltarët dhe projektakti shoqërohet me efekte financiare në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të Bashkisë Kamëz, në çdo rast i dërgohet për mendim organit ekzekutiv, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes projektaktit. Në qoftë bashkia nuk shprehet brenda këtij afati, konsiderohet që është dhënë miratimi në heshtje dhe projektakti kalon për shqyrtim sipas procedurës së zakonshme.
 5. Projektaktet duhet të paraqiten sekretarit të këshillit bashkiak si rregull jo më pak se 40 ditë para. Projektaktet regjistrohen në librin e akteve të këshillit.
 6. Projektakti dhe dokumentet shoqëruese duhet të dërgohen këshillit edhe elektronikisht (email) në adresën zyrtare të këshillit.
 7. Sekretari i këshillit, u paraqet projektaktet komisioneve përkatëse, si rregull jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes së këshillit bashkiak.
 8. Projektaktet paraqiten në tre kopje origjinale, ku njëra kopje qëndron në protokollin e bashkisë dhe dy kopjet e tjera i përcillen këshillit bashkiak.
 9. Këshilli bashkiak mund të vendos shfuqizimin apo anulimin e një vendimi të marrë prej tij. Pasojat e shfuqizimit apo anulimit të aktit, janë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

Neni 44

Organizimi i shqyrtimit të projektaktit

1. Kryetari këshillit urdhëron shpërndarjen e projektaketeve këshilltarëve. Në njoftimin për shpërndarjen e projektaketeve, kryetari këshillit sipas tematikës në bashkëpunim dhe me drejtuesit e komisioneve cakton komisionet përgjegjëse dhe atyre që duhet të japin mendim për to.
2. Drejtuesi i komisionit përkatës, organizon shqyrtimin e projektaktit dhe përgatit raportin për mbledhjen e këshillit. Drejtuesi komisionit mund të caktoj nga një këshilltar përgjegjës për relatimin e çdo projektakti.
3. Në mbledhjen e këshillit projektaktet shqyrtohen pas raportimeve që bëjnë paraqitësit etyre dhe komisionet përkatëse.
4. Projektaktet nuk merren në shqyrtim, në rast se të interesuarit nuk paraqiten në mbledhjen e këshillit.
5. Në rastet kur, paraqitësit e projektaktit nuk bien dakord me raportin dhe vlerësimet e komisionit, ata mund të paraqesin në këshill një raport plotësues.
6. Kur këshilli vëren mangësi në projekt, vendos rishqyrtimin e tij në mbledhjen e ardhshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Neni 45

Procedura e zhvillimit të mbledhjeve

1. Kryetari i këshillit, pas verifikimit të pjesëmarrjes nga sekretaria, deklaroron hapjen e mbledhjes, komunikon rendin e ditës dhe paraqet për votim, së bashku me ndryshimet përkatëse nëse ka.
2. Pas miratimit të rendit të ditës, fjala i jepet Kryetarit të Bashkisë dhe në rast mungese të tij, zëvendëskryetarit, për mbajtjen e fjalës së rastit dhe relativimin e projektakteve të propozuara për shqyrtim dhe miratim.
3. Për të siguruar një ecuri normale dhe efektive të mbledhjeve të këshillit, pas ezaurimit të parashikimeve pikës 2 të këtij neni, ndiqet kjo procedurë:
4. Shprehet mendimi i komisionit të përhershëm, për projektaktin e paraqitur.
5. Drejtohen pyetje nga këshilltarët.
6. U jepet përgjigje, pyetjeve të këshilltarëve.
7. Diskutime nga këshilltarët.
8. Shprehen mendimet e drejtuesve të grupeve të këshilltarëve.
9. Votohen propozimet për ndryshime të mundshme në projekt, sipas radhës së paraqitjes së tyre.
10. Kryhet votimi i hapur ose i fshehtë, sipas vendimit që ka marrë vetë këshilli.

Neni 46

Radha e diskutimeve

1. Këshilltari fillon diskutimin, pasi i jepet fjala nga drejtuesi i seancës.
2. Këshilltari e kërkon fjalën, me ngritjen e dorës ose me shkrim.
3. Këshilltari diskuton vetëm një herë për problemin që shqyrtohet.
4. Kryetari i këshillit, përcakton radhën e diskutimeve, duke mbajtur parasysh kohën e kërkesës, si dhe kombinimin e grupeve të këshilltarëve.
5. Kryetarët e grupeve kanë të drejtë të diskutojnë jashtë radhe, në rast se e kërkojnë fjalën.
6. Këshilltari mund të flasë nga vendi, në këmbë ose ulur, sipas zgjedhjes së tij.
7. Këshilltarit mund t'i ndërpritet diskutimi, kur nuk diskuton për problemin që shqyrtohet apo nuk i përmbahet rregullave të etikës, pasi është paralajmëruar për një fakt të tillë.

Neni 47

Çështjet procedurale

1. Këshilltarit, i jepet fjala menjëherë për çështjet procedurale që prekin zbatimin e kësaj rregulloreje, veçanërisht të zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit.
2. Çështjet procedurale paraqiten shkurt, duke përcaktuar qartë thelbin e tyre.
3. Këshilltarit i ndërpritet fjala, kur nuk respekton kërkesat e mësipërme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Neni 48

Kohëzgjatja e diskutimeve

1. Këshilli vendos si rregull një kohëzgjatje të caktuar për çdo diskutim në fillim të seancës, e cila duhet të respektohet nga këshilltarët që e marrin fjalën.
2. Këshilltari, lajmërohet për përfundimin e diskutimit, një minutë para mbarimit të kohës së diskutimit.
3. Në rast se folësi e tejkalon atë, ai paralajmërohet nga drejtuesi i seancës për ta përfunduar dhe nëse ai vazhdon, e drejta e fjalës i hiqet.
4. Folësi paralajmërohet nga drejtuesi i seancës edhe kur ai shmanget nga tema kryesore e diskutimit. Folësit i hiqet e drejta e fjalës, vetëm për atë problem të rendit të ditës, nëse kjo shkelje vazhdon.
5. Një këshilltar mund të shfrytëzojë kohën e kolegut, me kusht që të ketë qenë regjistruar më parë për diskutim dhe kur shprehen publikisht në mbledhje.
6. Kryetari dhe zëvendëskryetari i bashkisë, drejtuesit dhe këshilltarët e ngarkuar për të folur, në emër të grupeve, mund ta marrin fjalën për diskutim sa herë që e kërkojnë.

Neni 49

Replika gjatë diskutimeve

1. Këshilltari ka të drejtën e replikës, në rast se i përmendet emri në diskutimin e parafolësit.
2. Replika është një qëndrim i paraqitur në mënyrë të shkurtër, për përmbajtjen e problemit që është në diskutim.
3. Replika bëhet menjëherë, pas diskutimit dhe nuk mund të vazhdojë më shumë se 2 minuta.
4. Pas replikës, nuk ka kundër replikë.

Neni 50

Ndërprerja apo mbyllja e diskutimeve

1. Kryetari i Këshillit, shpall mbylljen e diskutimeve, nëse lista emërore e diskutuesve ka përfunduar.
2. Këshilltarët mund të heqin dorë nga diskutimi në çdo kohë, në rast se e çmojnë të arsyeshme.
3. Mungesa në sallën e mbledhjeve, në çastin e radhës për diskutim, konsiderohet heqje dore nga diskutimi.
4. Këshilltarët mund të kërkojnë mbylljen e diskutimeve me mirëkuptim.
5. Këshilltari i listës emërore, nuk mund të pengohet të diskutojë, në rast se nuk shpreh mirëkuptimin për mbylljen e tyre.
6. Nëse pranohet propozimi për ndërprerjen e diskutimeve, fjala i jepet drejtuesve të grupeve, të cilët dëshirojnë të diskutojnë.
7. Propozimet si rregull, hidhen në votim sipas radhës së depozitimit të tyre.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

Neni 51

Sjellja e këshilltarëve gjatë mbledhjes së këshillit dhe komisioneve

Këshilltari, gjatë ushtrimit të mandatit, respekton rregullat e sjelljes, të parashikuara në këtë Rregullore apo akte të tjera të miratuar për këtë qëllim. Rregullat e përcaktuara në këtë kre dhe masat disiplinore zbatohen për shkeljen e rregullores nga ana e këshilltarëve.

Neni 52

Rregulli në mbledhjet e këshillit/komisioneve

1. Në sallën e mbledhjeve marrin pjesë këshilltarët, kryetari bashkisë dhe në mungesë të tij zëvendëskryetari dhe stafi që shoqëron kryetarin e bashkisë.
2. Në mbledhje mund të marrin pjesë me cilësinë e të ftuarit, vetëm personat e autorizuar nga kryesia e Këshillit.
3. Pjesëmarrësit në mbledhje e Këshillit qëndrojnë në vendet e caktuara për ta dhe respektojnë rregullat e mbledhjes.
4. Këshilltari, gjatë ushtrimit të mandatit, respekton rregullat e sjelljes, të parashikuara në këtë Rregullore apo akte të tjera të miratuar për këtë qëllim.
5. Rregullat e përcaktuara në këtë kre dhe masat disiplinore zbatohen për shkeljen e Rregullores nga ana e këshilltarëve.
6. Kryetari/drejtuesi i mbledhjes mund të ndërpresë mbledhjen në rastet kur prishet rregulli i vendosur, ose pengohet ecuria normale e mbledhjes së Këshillit.
7. Në rast se pengimi i zhvillimit të mbledhjes shkaktohet nga ana e këshilltarëve atëherë drejtuesi i mbledhjes merr masat disiplinore të përcaktuara në këtë rregullore.
8. Kur mbledhja pengohet nga ana e të ftuarëve, kryetari i këshillit/drejtuesi i mbledhjes fton të ftuarit të lënë menjëherë sallën e këshillit bashkiak dhe në rast se refuzojnë atëherë kryetari i këshillit kërkon ndihmën e shërbimit të policisë bashkiake. Mbledhja rifillon menjëherë pas vendosjes së qetësisë në sallë.
9. Me propozim të kryetarit ose të një grupi këshilltarësh, mbledhja shtyhet për një datë tjetër, me të njëjtin rend dite apo duke shtuar dhe pika të tjera për diskutim.
10. Ndalohet përdorimi i telefonave celularë (telefonata, filmime etj) përgjatë mbledhjeve të këshillit dhe komisioneve. Drejtuesi i mbledhjes së këshillit/komisionit ju kërkon këshilltarëve që të gjitha telefonat celularë të mbahen të heshtur ose të vendosen në dridhje deri në përfundim të saj. Mos respektimi i këtij rregulli nga këshilltarët konsiderohet prishje e mbledhjes së Këshillit apo komisionit të përhershëm, dhe përbën shkak për marrjen e masave disiplinore. Kur ky rregull shkelet nga personat e tjerë pjesëmarrës në mbledhje, atëherë drejtuesi i mbledhjes merr masa që ato të dalin jashtë sallës.

Neni 53

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore që zbatohen ndaj këshilltarëve të këshillit bashkiak janë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- a. vërejtje;
 - b. heqje e së drejtës së fjalës gjatë mbledhjes së këshillit/komisionit;
 - c. përjashtim nga mbledhja e këshillit/komisionit;
 - d. përjashtim nga pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit/komisionet e këshillit deri në 2 mbledhje radhazi.
2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, janë masa të lehta. Masat e lehta nuk ankimohen.
 3. Masat disiplinore, të parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, janë më të rënda. Këshilltari ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre.

Neni 54

Dhënia e masave disiplinore

1. Masa disiplinore e “vërejtjes” jepet kur:
 - a. këshilltari në të njëjtën mbledhje të këshillit bashkiak/mbledhjes së komisioni përsërit të njëjtat veprime për të cilën i është tërhequr vëmendje më parë për pengimin zhvillimit të mbledhjes së këshillit/komisionit;
 - b. këshilltari cenon rendin në mbledhjen e këshillit/mbledhje komisioni apo pengon këshilltarët e tjerë të flasin apo zhvillimin e mbledhjes.
2. Masa disiplinore e “vërejtjes” jepet nga drejtuesi i mbledhjes së këshillit apo drejtuesi i mbledhjes së komisionit, e cila pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.
3. Në rast se këshilltari vazhdon të kryejë të njëjtat veprime apo ofendon drejtuesin e mbledhjes, anëtarët e këshillit, kryetarin e bashkisë, atëherë drejtuesi i mbledhjes i heq menjëherë fjalën, e cila nuk i jepet me deri në përfundim të mbledhjes së këshillit bashkiak/komisionit.
4. Nëse drejtuesi i mbledhjes së këshillit/komisionit nuk konstaton ose nuk vepron me nismën e tij, çdo këshilltar i pranishëm në mbledhje ka të drejtë të informojë drejtuesin e seancës për të vepruar sipas pikës 3 të këtij neni. Drejtuesi i mbledhjes së këshillit/komisionit vendos menjëherë për këtë kërkesë.
5. Masa disiplinore e “përjashtimit nga mbledhja e këshillit ose mbledhja e komisionit” jepet nga drejtuesi mbledhjes/komisionit kur këshilltari edhe pas dhënies së vërejtjes vazhdon të pengoj zhvillimin e mbledhjes, përdorë fjalë fyese, diskriminuese, cenon personalitetin e drejtuesit të mbledhjes së këshillit/komisionit, këshilltarëve, stafit të bashkisë, të ftuarve, personave të tjerë.
6. Masa e përjashtim nga pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit/komisionet deri në 2 mbledhje, jepet ndaj këshilltarit që bën thirrje për përdorim dhune, pengon zhvillimin e rregullt të mbledhjes së këshillit/ komisionit, shkakton rrëmujë në mbledhje, fyen, kërcënonose dhunon këshilltarët e tjerë, drejtuesin e mbledhjes, të ftuarit ose persona të tjerë, apo përdor fjalë fyese për kryetarin e bashkisë apo refuzon të dalë nga salla e mbledhjes/komisionit, hyn ose përpiqet të hyjë në sallën e këshillit përpara mbarimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- masëdisiplinore të dhënë.
7. Këshilltarit që i është dhënë masa e përjashtimit deri në 2 mbledhje nuk lejohet të hyjë në ambientet e bashkisë Kamëz deri në përfundimin e masës.
 8. Në rast se këshilltari, ndaj të cilit është marrë masa e parashikuar në pikën 6 të këtij neni, refuzon të dalë ose përpiqet të hyjë në sallën e mbledhjeve/komisioneve përpara mbarimit tëkësaj mase disiplinore, afati i masës dyfishohet. Drejtuesi i mbledhjes mund të kërkoj ndihmën e punonjësve të policisë bashkiake për të vendosur rendin dhe qetësinë në sallë. Masa e përjashtim nga pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit/komisionet e këshillit deri në 2mbledhje radhazi, jepet nga drejtuesi i mbledhjes së këshillit/komisionit. Çdo këshilltar iprekur nga sjellja e këshilltarit përkatës mund ti propozoj drejtuesit të mbledhjes marrjen ekësaj mase.
 9. Masa disiplinore e përjashtimit nga pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit/komisionet dhe masa disiplinore e përjashtimit nga pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit/komisionet deri në 2 mbledhje mund të ankimohet në komisionin e mandateve dhe rregullores. Së bashku me ankimin, këshilltari duhet të depozitoj provat dhe dokumentet që ai vlerëson të nevojshme për këtë procedurë.
 10. Komisioni i mandateve dhe rregullores shqyrton brenda 72 orëve kërkesën e paraqitur dhe njofton këshillin bashkiak dhe këshilltarin e përjashtuar në lidhje me vendimin e marrë.
 11. Masa disiplinore e parashikuar në nenin 53, pika 1, shkronja “ç”, shoqërohet me sanksion financiar të ndalimit të shpërblimit të këshilltarit për mbledhjet që ai nuk merr pjesë.

Neni 55

Votimi në mbledhjet e Këshillit

1. Votimi në mbledhjet e Këshillit, bëhet i hapur ose i fshehtë, sipas vendimit që merr Këshilli.
2. Procesi i votimeve të akteve me karakter individual, kryhet si rregull me votim të fshehtë.
3. Procedura e votimit të fshehtë, organizohet nga një komision i përbërë nga 3 deri në 5 këshilltarë të zgjedhur, me votim të hapur nga këshilli.
4. Vendimet e Këshillit, kur nuk përcaktohet ndryshe në ligj, merren me shumicën e votavetë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
5. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “e/1”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015.
6. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”.
7. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave;
8. Projektet në këshillin bashkiak quhen të miratuara, kur ato kryhen në përputhje me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

përcaktimet e parashikuara në nenit 55 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe të kësaj rregulloreje.

9. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tyre.
10. Aktet me karakter individual, hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre, subjekteve përkatëse.

Neni 56

Raportet e Kryetarit të Bashkisë me Këshillin

1. Kryetari i Bashkisë merr masa për zbatimin e akteve të këshillit.
2. Kryetari i Bashkisë merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve në përputhje me rendin e ditës, të përcaktuar nga këshilli, si dhe akteve të paraqitura nga ai vetë.
3. Kryetari i Bashkisë, raporton para këshillit, sa herë kërkohet prej tij, për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë.
4. Kryetari i Bashkisë, i kthen për rishqyrtim, jo më shumë se një herë në këshill vendimet, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkisë.
5. Kryetari i Bashkisë, u përgjigjet pyetjeve që i drejtojnë këshilltarët gjatë raportimit, apo organizimit të seancave të veçanta.
6. Pyetjet që i drejtohen Kryetarit të Bashkisë, duhet të jenë të shkurtra dhe të kenë të përcaktuar qartë, çështjen për të cilën kërkohet informacion.
7. Këshilltari që bën pyetjen, ka të drejtën gjithashtu që të përcaktojë, nëse përgjigjet i do me shkrim apo me gojë.
8. Pyetjet që kërkohet kohë për nxjerrje të dhënash, bëhen 5 ditë përpara dhe formulohen me shkrim. Në të kundërt Kryetari i Bashkisë, ka të drejtën të kërkojë kohën e duhur për përgatitjen e përgjigjeve.
9. Në rastet kur Kryetari i Bashkisë nuk është në gjendje t’u japë përgjigje pyetjeve të drejtuara, bën shpjegimet e nevojshme për këtë.
10. Kur këshilltari që ka bërë pyetjet mungon, përgjigjet jepen në një mbledhje tjetër.
11. Përpara se të fillohet me përgjigjet, këshilltari që ka drejtuar pyetjet, mund të sqarojë
12. ndonjë çështje që lidhet me arsyet e pyetjeve të bëra.
13. Gjatë përgjigjeve të pyetjeve, nuk lejohet të bëhet debat.
14. Këshilltari që ka bërë pyetjet dhe ka marrë përgjigje, ka të drejtë të diskutojë deri 2 minuta, duke dhënë konsideratën e tij për to.
15. Kur këshilltari që ka bërë pyetjet, tërhiqet nga mendimi i mëparshëm, këtë e deklaron me shkrim në kryesinë e Këshillit, para zhvillimit të mbledhjes.

Neni 57

Procesverbali i mbledhjeve të këshillit bashkiak

1. Në mbledhjet e këshillit mbahet procesverbal nga sekretaria e këshillit.
2. Në fund, pasi procesverbali kontrollon, firmoset nga sekretari dhe së paku nga 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

këshilltarë.

3. Procesverbali në Këshill, mund të mbahet edhe me stenografi ose me mjete regjistrimi. Gjithsesi, edhe në këto raste, teksti e tij hidhet në letër dhe firmoset sipas rregullit të mësipërm.

Neni 58

Hyrja, vendosja e këshilltarëve e të ftuarve dhe siguria në sallën mbledhjeve/komisioneve

1. Kryesia e këshillit, përcakton vendin e qëndrimit të këshilltarëve, titullarëve të bashkisë dhe të ftuarve si më poshtë:
 - a. Në pjesën ballore kryetari dhe sekretari i këshillit.
 - b. Në pjesën anësore, në të majtë të kryesisë, zë vend sekretaria e këshillit.
 - c. Në pjesën anësore, në të djathtë të kryesisë, zënë vend titullarët e bashkisë, sipas rastit.
2. Në vijim të titullarëve të bashkisë, zënë vend këshilltarët, sipas grupimeve politike dhe sipas rezultatit të zgjedhjeve vendore.
3. Në fund të sallës, për aq vende sa ka salla, zënë vend të ftuarit dhe përfaqësuesit e medias elektronike dhe të shkruar.
4. Për të siguruar apo vendosur rendin dhe qetësinë, në mjediset e zhvillimit të mbledhjevetë këshillit, shërben shërbimi i policisë bashkiake, i cili vepron sipas urdhrave të drejtuesit mbledhjeve të këshillit dhe në përputhje me aktet e miratuara për këtë qëllim. Drejtuesi i mbledhjeve të komisionit mund të kërkojnë ndihmën e shërbimeve të policisë bashkiake përtë siguruar apo vendosur rendin dhe qetësinë përgjatë zhvillimit të mbledhjes.
5. Shërbimet e policisë bashkiake sigurojnë kontrollin e hyrje-daljeve të të gjithë personavenë mjediset e zhvillimit të mbledhjeve të këshillit/komisionet.
6. Kur dyshohet se personi mban armë, lëndë plasëse, sende të dëmshme ose materiale të papërshtatshme, të cilat mund të pengojnë zhvillimin e veprimtarisë së këshillit bashkiak, ai kontrollohet edhe fizikisht.
7. Në rastet kur personi nuk pranon të kontrollohet, shërbimi i policisë bashkiake ndalon hyrjen e tij në mjediset e bashkisë/këshillit bashkiak dhe vepron sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
8. Kryetari i Bashkisë merr masa të miratojë aktet përkatëse për sigurimin e shërbimit të policisë bashkiake sipas parashikimeve të këtij neni.

Neni 59

Dispozita të fundit

1. Kryesia e këshillit dhe Kryetari i Bashkisë, sigurojnë kushtet dhe mjetet e nevojshme materiale dhe financiare për zhvillimin normal të veprimtarisë së këshillit bashkiak.
2. Kur ngrihen pretendime gjatë zhvillimit të mbledhjes së këshillit lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje, është kompetencë e drejtuesit të mbledhjes për të vendosurpër pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.
3. Kur ngrihen pretendime për interpretimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje gjatë zhvillimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- të mbledhjeve të komisioneve, drejtuesi i mbledhjes së komisionit vendos për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.
4. Me kërkesë të këshilltarëve të interesuar, kërkesa mund t'i paraqitet komisionit për mandatet dhe rregulloren, i cili duhet të bëjë, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, interpretimin përfundimtar për çështjen e kërkuar për interpretim.

Komisioni “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkik Kamëz.”

Merita Prenga Kryetare Komisioni
Hysen Koldashi Anëtar
Shkëlqim Kosiqi Anëtar
Hajri Hoxha Anëtar
Nexhmije Rama Anëtare
Mimoza Lusha Anëtare
Sefedin Afmati Anëtar